

VENDIM
Nr.553, datë 2.6.2009

**PËR SHPALLJEN KATEGORIZIMIN DHE EMËRTIMIN E PORTIT “VLORA-1”, NË
GJIRIN E VLORËS, - “PORT I HAPUR PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 7 të nenit 18 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9231, datë 13.5.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, të objektit “Port “Vlora -1””, në gjirin e Vlorës, të ndërtuar sipas marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në këtë gji, me specifikat e mëposhtme:

a) Koordinatat gjeografike: N 40° 27' 53''
E 19° 26' 17'';

b) Veprimtaria detare: Ngarkim –shkarkim naftë, GNL, e të nënprodukteve të tyre dhe produkteve të tjera;

c) Operativiteti: Port i hapur për trafik ndërkombëtar, 24 orë;

ç) Shfrytëzimi: Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;

Faza II: Pronë e shtetit shqiptar, e lirë, për t'u shfrytëzuar sipas vullnetit të shtetit, pas përfundimit të koncesionit;

d) Menaxhimi: Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;

Faza II: Shteti shqiptar, përfaqësuar nga organet qendrore përgjegjëse, në fushën e porteve dhe të zhvillimit ekonomik;

dh) Pronësia: Shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave.

Kufizime: Në përdorim të koncesionarit “La Petrolifera Italo Albanese sh.a.”, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;

e) Marrëdhënia me institucionin përgjegjës për transportin: Raportim periodik për vëllimin e punës së kryer në port;

ë) Detyrime të tjera: Person kontakti dhe adresë kontakti, në çdo kohë;

Faqe zyrtare, në gjuhën shqipe dhe në anglisht, që përmban informacion të plotë për rregullat e funksionimit të portit, tarifatat dhe normat ditore të ngarkim-shkarkimit, si dhe informacion për situatën e anijeve në port.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të marrin masa, që, në bashkëpunim me koncesionarin, të bëjnë funksionale të gjitha strukturat respektive shtetërore, përfshirë komunikimin nominal të personave, që do t'i ushtrojnë këto funksione në port.

3. Porti do të bëhet funksional (operativ) pas plotësimit të detyrimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha